



**INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS**

REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO OBRAZOVANJE, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

RAPORTI I KOMISIONIT PROFESIONAL-SHKENCOR PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS SË ZGJEDHJES SË HULUMTUESIT TË PAVARUR NË INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS

Në bazë të Ligiit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë kërkimore-shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit (2024) të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 109/25 të datës 15.12.2025 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të punës numër 03/L212, vendimit nr. 110/25 të datës 18.12.2025, Këshilli Shkencor i Institutit ka shpallur konkurs për zgjedhje/avancim të një Hulumtuesi të pavarur për kurrikula në arsimin fillor në Institutin Pedagogjik të Kosovës, ishte pjesë e shqyrtimit nga ky komision.

VLERËSIMI PROFESIONAL DHE SHKENCOR

Detyra e komisionit është të shqyrtojë dokumentacionin dhe të hartojë raportin profesional. Me hartimin e raportit përfundon puna dhe përgjegjësia e këtij komisioni. Komisioni për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së hulumtuesit, i emëruar në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, ka këtë përbërje: Prof.As.Dr.Amantina Pervizaj Kelmendi - kryetare; Prof.Asoc.Dr.Arlinda Beka - anëtare dhe Prof.As.Dr.Vjollca Ahmedi – anëtare.

Komisioni, pasi e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkurs, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor.

Duke u mbështetur në dokumentacionin dhe dosjen e dorëzuar nga kandidati, komisioni vërteton se në konkursin e shpallur më datë 11.09.2025, në gazetën "Epoka e re" dhe në faqen zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe në sistemin e SIMBNJ, për pozitën e **hulumtuesit të pavarur për kurrikula në arsimin fillor**, në Institutin Pedagogjik të Kosovës, ka konkurruar këta kandidatë:

- 1.Arjana Haxhikadrija Zhubi
- 2.Nusret Mulaki
- 3.Zylfije Tahiri
4. Lirije Bytyqi Beqiri
5. Sadik Ahmataj

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutit të Institutit Pedagogjik, si dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, procedura vlerësuese për zgjedhje/rizgjedhje mbështetet në kriteret që dalin nga kushtet si në vijim:

- Të jetë i/e regjistruar në studimet e doktoratës në programe relevante me pozitën e shpallur dhe fushëveprimtarinë e Institutit Pedagogjik të Kosovës;
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore të indeksuara; Punimet e publikuara në revista shkencore të indeksuara duhet të jenë të njohura sipas rregulloreve në fuqi;
- Të ketë punime të publikuara në revistën “Kërkime Pedagogjike”;
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit, nga fusha përkatëse;
- Të ketë marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, nga fusha përkatëse;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për aktivitetet shkencore e profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs.

Sipas konkursit në fjalë kandidati I zgjedhur pritët të kryej këto detyra:

- Studion probleme të ndryshme nga fusha e edukimit, në kuadër të fushëveprimtarisë së Institutit;
- Bën hulumtime në terren në bashkëpunim me punëtorët e tjerë shkencorë të divizionit dhe departamenteve;
- Përgatit për botim raporte të studimeve të kryera, materiale e botime nga fushëveprimtaria e divizionit përkatës;
- Angazhohet për aftësim profesional dhe avancim në karrierë;
- Hulumton cilësinë e planeve dhe programet mësimore në arsimin fillor dhe jep rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e planeve dhe të programeve mësimore;
- Analizon (vlerëson) përshtatshmërinë e praktikave mësimore me kompetencat e Kurrikulës;
- Studion metodologjitë e mësimdhënies në raport me kërkesat e kurrikulës në arsimin fillor;
- Hulumton ngarkesën e programeve me përmbajtje në raport me moshën e nxënësve;
- Harton projekte hulumtuese për të studiuar praktikat mësimore në arsimin fillor;
- Ofron rekomandime të bazuara në dëshmi për përmirësimin e kurrikulave dhe metodologjive të mësimdhënies në arsimin fillor;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë që i cakton udhëheqësi i divizionit në bashkëpunim me punëtorët shkencorë, në kuadër të projekteve të përbashkëta hulumtuese-shkencore;
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

Komisioni, pasi e verifikoi dokumentacionin e dorëzuar, ka konstatuar se të 5 kandidatet i plotësojnë kushtet formale juridike për t'ju nënshtruar procedurave të për zgjedhjes për *Hulumtues të pavarur për kurrikula në arsimin fillor*. Komisioni i ka shqyrtuar dosjet e kandidateve dhe në bazë të kriterëve të shpallura në konkurs, përgaditjen akademike, përvojën e punës conform kërkesave të pozitës, të arriturat profesionale shkencore, projektet për zhvillimin e punës profesionale-shkencore, i ka paraqitur të dhënat biografike dhe bibliografike si më poshtë.

Tabela 1

Shënimet përmbledhëse për kandidatin e paraqitur për pozitën: Hulumtues të pavarur për kurrikula në arsimin fillor në Institutin Pedagogjik të Kosovës

Numër	Emri dhe mbiemri	Biografia (CV)	Grada dhe thirrja shkencore	Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës	Përvoja kërkimore - shkencore			Dëshmi se kandidati nuk është i dënuar
						Publikimet shkencore: Artikuj në revista të indeksuara	Kumtesat në konferenca ndërkombëtare	Botime të veçanta	
1	Arjana Haxhikadrija Zhubi	Po	PhD Programi: mësimdhënia dhe të mësuarit <i>Master Pedagogjik – Teorik-Shkencor</i>	52 vjeç 26.03. 1973	24 vite	2	12	1	PO
2.	Nusret Mulaki	Po	<i>PhDc.</i> Curriculum and instruction <i>Master Mësim Lëndor (Specializim në Histori)</i>	30 vjeç 16.07. 1995	6 vite	Jo	2	JO	JO

Numër	Emri dhe mbiemri	Biografia (CV)	Grada dhe thirrja shkencore	Mosha (datëlindja)	Përvoja e punës	Përvoja kërkimore - shkencore			Dëshmi se kandidati nuk është i dënuar
						Publikimet shkencore: Artikuj në revista të indeksuara	Kumtesat në konferenca ndërkombëtare	Botime të veçanta	
3.	Zylfije Tahiri	PO	<i>PhDc</i> English Language and Literature <i>Master</i> English Language and Literature	29 vjeç 09.04. 1996	4 vite	5	2	2	PO
4.	Lirije Bytyqi Beqiri	PO	<i>PhDc</i> Shkenca arsimore <i>Master</i> Shkenca Pedagogjike	46 02.12. 1980	23 vite	13	9	7	PO
5.	Sadik Ahmataj	PO	Pa dëshmi	Pa dëshmi	Pa dëshmi	JO	JO	JO	JO

Mbështetur në të dhënat e prezantuara nga kandidati, i cili është paraqitur për pozitën e zgjedhjes hulumtues i pavarur, duke iu referuar Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, komisioni për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes, i emëruar me vendim nr. prot. 110/25, të datës 28.12.2026, në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, në përbërje me:

Prof.Ass.dr.Amantina Pervizaj Kelmendi - Kryetare; Prof.Asoc.dr. Arlinda Beka - Anëtare; Prof.Ass.dr. Vjollca Ahmedi - Anëtare, ka përgatitur këtë raport për Këshillin Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Duke u mbështetur në analizën e plotë dhe të detajuar të dokumentacionit të dorëzuar, në kushtet e përcaktuara në Konkurs, në Rregulloren për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencorë dhe Hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, si dhe në dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi, Komisioni ka vlerësuar në mënyrë objektive dhe të barabartë përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta për thirrjen “Hulumtues i pavarur”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se kandidatja **Lirije Bytyqi Beqiri**:

- është e përgatitur në mënyrë të plotë akademike në fushën e shkencave arsimore, me diplomë Master në Shkenca Pedagogjike dhe e regjistruar në studimet e doktoratës në programin “Shkenca Arsimore”, program plotësisht relevant me pozitën e shpallur, duke dëshmuar vazhdimësi dhe thellim profesional në fushën e edukimit dhe kurrikulës;
- ka mbi 13 vite përvojë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme pune në Institutin Pedagogjik të Kosovës, pikërisht në funksionin e hulumtueses për kurrikula në arsimin fillor (nga viti 2011), duke ushtruar në mënyrë të konsoliduar veprimtari kërkimore-shkencore në përputhje me misionin dhe fushëveprimtarinë e Institutit;
- gjatë kësaj periudhe ka realizuar hulumtime sistematike mbi plane dhe programe mësimore, analizë të ngarkesës kurrikulare, vlerësim të praktikave mësimore dhe hartim rekomandimesh të bazuara në dëshmi për përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar, duke demonstruar performancë të qëndrueshme dhe kontribut të drejtpërdrejtë institucional;
- ka realizuar dhe bashkërealizuar një numër të konsiderueshëm studimesh dhe botimesh profesionale-shkencore në fushën e kurrikulës, vlerësimit të performancës së shkollës, zhvillimit të shkathtësive të shkrim-leximit, kompetencave kurrikulare, mësimin në distancë dhe analizës së ndikimit të Covid-19 në arsim, duke kontribuar drejtpërdrejt në prodhimin e dijes shkencore brenda Institutit;
- ka publikuar punime si autore dhe bashkautore në botime të veçanta të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe në revistën shkencore “Kërkime Pedagogjike”, në përputhje me kërkesat e konkursit për publikime relevante nga fusha përkatëse;

- ka marrë pjesë aktive dhe ka prezantuar punime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, me trajtim të drejtpërdrejtë të çështjeve që lidhen me kurrikulën, kompetencën digjitale, mbingarkesën kurrikulare, vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe zhvillimin profesional të mësimitdhënësve;

- ka qenë e angazhuar në projekte kërkimore dhe profesionale që adresojnë analizën e cilësisë së planeve dhe programeve mësimore, zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe përgatitjen e rekomandimeve të bazuara në dëshmi, duke përmbushur në mënyrë substanciale detyrat e përcaktuara për pozitën e shpallur;

- ka hartuar dhe zbatuar programe të akredituara trajnimi për mësimitdhënës në bashkëpunim me MASHTI-n dhe partnerë ndërkombëtarë, duke dëshmuar kapacitet për transferimin e rezultateve kërkimore në praktikë, në përputhje me rolin e Institutit si institucion kërkimor-shkencor.

Komisioni thekson se, bazuar në natyrën e thirrjes për pozitën “Hulumtues i pavarur”, e cila në thelb ka ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore si funksion primar, përvoja mbi 13-vjeçare e kandidatës pikërisht në rol kërkimor brenda Institutit Pedagogjik të Kosovës përbën element thelbësor profesional që e diferencon atë në raport me përvoja të tjera profesionale që nuk kanë në thelb funksionin kërkimor. Përvoja e saj nuk është përvojë e përgjithshme në arsim, por përvojë specifike, e drejtpërdrejtë dhe e vazhdueshme në hulumtim shkencor institucional, çka përputhet plotësisht me esencën dhe qëllimin e kësaj thirrjeje.

Komisioni vlerëson se përvoja profesionale e kandidatës në arsimin fillor (si mësimitdhënëse dhe si hulumtuese), përvoja akademike në arsimin e lartë si bashkëpunëtoresh profesionale, si dhe angazhimi i saj i vazhdueshëm në projekte kërkimore-shkencore në kuadër të Institutit Pedagogjik të Kosovës, përbëjnë bazë të qëndrueshme, të konsoliduar dhe të mjaftueshme për ushtrimin e pavarur të funksionit kërkimor në fushën e kurrikulës.

Në analizë të të gjitha pikave të konkursit përgatitjes akademike, publikimeve shkencore, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, përvojës profesionale dhe përputhshmërisë me detyrat e pozitës. Komisioni konstaton se kandidatja i plotëson në tërësi kushtet e përcaktuara me konkurs dhe në rregulloret në fuqi për thirrjen “Hulumtues i pavarur”, duke demonstruar jo vetëm përmbushje formale të kriterëve, por përputhshmëri të plotë substanciale dhe funksionale me profilin profesional të kërkuar.

Vlerësimi është bërë mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, analizës së detajuar të përvojës dhe kontributit profesional-shkencor, si dhe në respektim të parimeve të meritokracisë, transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.


Në përfundim, Komisioni propozon zgjedhjen/avancimin e kandidatës **Lirije Bytyqi Beqiri** në thirrjen – pozitën “Hulumtues i pavarur” në Institutin Pedagogjik të Kosovës, pasi ajo demonstroi përmbushje të plotë, të dokumentuar dhe substanciale të kushteve të përcaktuara në konkurs dhe përputhshmëri të drejtpërdrejtë me kërkesat profesionale dhe shkencore të pozitës.

PËRFUNDIM

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013, si dhe Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, nr.01/B, nr.1740, të datës 11.06.2024, *Rregullores nr. 109/25 të datës 15.12.2025 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës*, si dhe bazuar në të arriturat profesionale dhe shkencore, komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së hulumtuesit të pavarur për mësimdhënie dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, i propozon Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës kandidaten Lirije Beqiri Bytyqi e cila i plotëson të gjitha kushtet e parapara në konkurs.

Prishtinë, më 26.02.2026

**Komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës
së zgjedhjes së hulumtuesit të pavarur në IPK**

1.  _____
2.  _____
3.  _____